



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 56 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 20 / 03 / 2025

VENDIM

Nr.10, date 20 /03 /2025

PËR

**SHQYRTIMIN E RAPORTEVE VJETORE 2024 PER GJENDJEN, SHFRYTEZIMIN,
MONITORIMIN DHE SIGURINE E DIGAVE DHE DAMBAVE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Kreu II, Neni 4 si dhe të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) mori në shqyrtim situatën e dorezimit të raporteve vjetore nga shfrytëzuesit e digave të mëdha për gjendjen, shfrytezimin, monitorimin dhe sigurinë e digave dhe dambave. Bazuar në informacionin e dhënë nga ITD dhe SKDM rezultoi se vetëm 20 shfrytëzues të digave të mëdha që përdorin digat e mëdha për ujë dhe 5 shfrytëzues të digave të mëdha që përdoren për prodhim hidroenergji kanë dorëzuar raportet vjetore për gjendjen, shfrytezimin, monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha që shfrytëzohen prej tyre. Nga ky informacion rezultoi se më së bashku që shfrytëzojnë më së 200 diga të mëdha për ujë dhe peshkim si dhe 5 shoqëri që shfrytëzojnë 5 diga të mëdha për prodhim hidroenergji nuk kanë dorëzuar akoma ndonjë raport sipas kërkesave të KKDM dhe legjislacionit në fuqi. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm KKDM

VENDOSI:

- 1- Tju rikërkoj 35 bashkive që shfrytëzojnë digat e mëdha për ujë dhe peshkim si dhe 5 shoqëri që shfrytëzojnë digat e mëdha për prodhim hidroenergji sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi të marrin masat për dorëzimin e këtyre raporteve brenda datës 31.03.2025 sipas kërkesave të VKM se mesipërme, neni 32.
- 2- Te informoj Ministrinë e Infrastruktura dhe Energji si dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit rural në lidhje me problematiken e mosdorëzimit të këtyre raporteve nga shfrytëzuesit e përmendur më sipër të dhëna në tabelën bashkëlidhur
- 3- ITD duhet të paraqesë një raport në lidhje me dorëzimin e raporteve vjetore për vitin 2024 sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi
- 4- KKDM të shqyrtoj dhe të miratoj Raportin vjetor për Keshillin e Ministrave në lidhje me gjendjen, monitorimin, shfrytezimin dhe sigurinë e digave dhe dambave të mëdha për vitin 2024 në mbledhjen e muajit Prill 2025.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen e detyrave dhe rekomandimeve të dhëna në këtë vendim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

PER KOMITETIN KOMBËTAR TE DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

